



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:143485

Datë: 18.10.2024

Numri i dokumentit: 06318224

Ac.nr.3556/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Adnan Konushevc, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: I.R.M nga fshati A..... Komuna e M....., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati B.K nga M....., kundër të paditurve: H.R.M, H.R.M, M.R.M, G.R.M, M.R.M, që të gjithë nga fshati A..... Komuna e M....., Xh.R.M, nga fshati A..... me vendbanim në fshatin R..... Komuna e S....., A.R.C (vajzërisë M.....), nga fshati A..... me vendbanim në fshatin Ll..... Komuna e D....., L.R.P (vajzërisë M.....) nga fshati A..... me vendbanim në fshatin B....., Komuna e R....., të cilat i përfaqëson G.M nga fshati A..... Komuna e M....., Z.I.G (vajzërisë M.....), me vendbanim në fshatin S..... Komuna e S....., M.M, M.I.M, J.I.M, V.I.M që të gjithë nga fshati A..... Komuna e M..... si dhe L.I.G (vajzërisë M.....), nga fshati A..... me vendbanim në fshatin P..... Komuna e S....., të cilët i përfaqëson Z.I.G (vajzërisë M.....), me vendbanim në fshatin S..... Komuna e S....., për vërtetim pronësie në bazë të ndarjes fizike, vlera e kontestit e pacaktuar, duke vendosur lidhur më ankesën e të paditurit H.M, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, C.nr. 270/2018, i datës 26.04.2022, në seancën jo publike të mbajtur me datë 11.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e të paditurit H.M nga fshati A..... Komuna e M....., PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, C.nr. 270/2018, i datës 26.04.2022, dhe lënda i kthehet gjykatës se shkallës së parë ne rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Më aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës se shkallës së parë, C.nr. 270/2018, i datës 26.04.2022 është vendosur:

I. APROVOHET të tërësi si e bazuar kërkesëpadia e precizuar me datën 08.12.2021 e paditësit I.R.M, nga dhe i lindur më 02.10.1974 në A..... Komuna e M....., me nr, personal:..... dhe VËRTETOHET, se i njëjti është pronar në 1/1 i paluajtshmerisë sipas ndarjes fizike dhe atë:

- Ngastrën P....., me sipërfaqe prej 1010 m² me kultur mal e klasit vendi i quajtur “L..... B.....-R.....”, Zona Kadastrale A.....,
- Ngastrën P-....., me sipërfaqe prej 5991 m² me kultur mal e klasit vendi i quajtur “R.....”, Zona Kadastrale A.....,
- Ngastrën P-....., me sipërfaqe prej 5367 m² me kultur mal e klasit vendi i quajtur “L..... B.....-A..... e U.....”, Zona Kadastrale A.....,
- Ngastrën P-....., me sipërfaqe prej 2100 m² me kultur arë e klasit vendi i quajtur “A..... V.....-V.....”, Zona Kadastrale A.....,
- Ngastrën P-....., me sipërfaqe prej 581 m² me kultur shtëpi, O..... dhe pemishte e klasit vendi i quajtur “M..... K..... –O.....”, Zona Kadastrale A.....,
- Ngastrën P-....., me sipërfaqe prej 1000 m² me kultur arë e klasit vendi i quajtur “A..... E Q.....-K..... i Q.....”, Zona Kadastrale A.....,
- Ngastrën P-....., me sipërfaqe prej 1364 m² me kultur arë e klasit vendi i quajtur “A..... E Q.....-K..... i Q.....”, Zona Kadastrale A.....,
- Ngastrën P-....., me sipërfaqe prej 1003 m² me kultur arë e klasit vendi i quajtur “A..... E Q.....-K..... i Q.....”, Zona Kadastrale A.....

II. Detyrohen të paditurit që paditësit t’i lejojë regjistrimin e të drejtës së pronësisë në regjistrin kadastral në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Komuna e M..... mbi ngastra kadastrale të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

III. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në M..... që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, paluajtshmerit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ti regjistrojë në librat kadastral në emër të paditësit I.R.M, nga fshati A..... Komuna e M.....

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale .

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur vetëm i padituri H.M, duke e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtë materiale me propozimin bërë Gjykatës se Apelit të Kosovës, që aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe padinë ta hedh poshtë, apo qe lëndën t’ia kthejë në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes te autorizuarit të tij në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit, të cilën se fundi herë e ka precizuar më parashtrësën e datës 08.12.2021, më kërkesën që gjykata pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave te propozuara te bie aktgjykim me te cilin do te aprovon në tërësi kërkespadinë e paditësit për vertetim të pronësisë nga baza e ndarjes fizike ne ngastrat e cekura me decidivishtë ne petitum të padisë. Te paditurit të obligohen qe paditësit t'ia njohin një të drejtë te tillë dhe te lejojnë qe paditësi te regjistrohet si pronar i vetëm i ngastrave lëndore ne librat publik të paluajtshmërive në Drejtorinë e Gjeodezisë në M.....

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën sipas propozimit të palëve ndërgjygjëse ka nxjerrë dhe administruar provat shkresore në bazë te se cilave ka konstatuar këtë gjendje faktike:

Bazuar në aktvdekjen e të ndjerit I.M me nr..... e datës 05.10.2018 gjykata ka konstatuar faktin se të paditurit Z.G.M, M.M, M.M, J.M, L.M dhe V.M janë pasardhësit e të ndjerit I.M.

Nga aktvdekja e të ndjerës H.M me nr..... e datës 10.03.2017 gjykata ka konstatuar faktin se të paditurit M.M, H.M, M.M , H.M, G.M, Xh.M, A.M, L.P.M janë pasardhësit e të ndjerës H.M.

Në bazë të aktvdekjeve të lëshuara për të ndjerët I.M dhe H.M, gjykata vërtetoi edhe legjitimitetin pasivë të të paditurve, pasi që sipas fletës poseduese kemi pasur të bëjmë me bashkëpronësi të paditësit I.M, I.M i ndjerë , H.M e ndejrë dhe G.M, andaj të paditurit kanë legjitimitet pasivë çka edhe nuk u kontestua nga askush nga palët.

Në bazë të certifikatave të pronës dt.06.09.2018 dhe numër dt.10.10.2019 dhe dt,06.09.2018 dhe dt,10.10.2019, gjykata vërtetoi faktin se kemi pasur që kanë të bëjmë me bashkëpronësi ku paditësi në këtë rast është bashkëpronarë me 1/16 e tërë pasurisë.

Nga konstatimi i ngastrave objekt kontesti i hartuar me dt.08.02.2019 nga gjeodeti H.Th si dhe skicat e këtyre ngastrave se bashku me fletat poseduese të ngastrave në fjalë, gjykata vërtetoi faktin se kemi të bëjmë me ndarje të pasurisë ndarje fizike të paluajtshmerisë dhe se ndarja ishte regjistruar në Drejtorinë Për Gjeodezi Pronësi dhe Kadastër në M....., kuptohet si ndarje fizike pasi që ende figuron si bashkëpronësi.

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar, gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispoziten e nenit 1 pika 1, nenit 2 pika 1, nenit 43, nenit 51.1 dhe nenit 56 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (tutje LPDTS-së) , ka ardhur në përfundimin se kërkesa e paditësit është e bazuar , pasi qe te gjithë të paditurit, më përjashtim të paditurit H.M i cili ja ka

kontestuar kërkespadinë paditësit, të tjerët nuk e kanë kundërshtuar kërkespadinë e paditësit, me çka nën rrethanën e tillë e duke marrë për bazë se gjykata nga konstatimi i ngastrave objekt kontesti i hartuar me datë 08.02.2019 nga gjeodeti H.Th si dhe skicat e ngastrave kontestuese se bashku me fletat poseduese të ngastrave në fjalë, ka vertetur faktin se kemi të bëjmë me ndarje fizike të paluajtshmërisë dhe se ndarja ishte regjistruar në Drejtorinë për gjeodozi, kadastër dhe pronësi në M....., kuptohet si ndarje fizike pasi që ende figuron si bashkëpronësi, por këtë ndarje nuk e kontestuan pothuajse nga asnjë bashkëpronarë i tyre, ku në rastin konkret përpos bazës juridike gjykata u bind se ekziston edhe baza faktike andaj edhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, si të rregullt dhe të bazuar në ligj nuk e gjen Gjykata e Apelit, për shkak se kjo gjykatë me vlerësimin e aktgjykimit të ankimuar, pretendimeve ankimore dhe shkresave të lëndës ka konstatuar se në rastin konkret aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n), e lidhur me neni 182.1 dhe 160.4 të LPK. Gjendja faktike po ashtu del të mos jetë hetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë me çka për rrjedhojë ka pas edhe aplikimin e gabaur të drejtës materiale për të cilën shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset vet sipas detyres zyrtare.

I bazuar qëndron pretendimi ankimor i të paditurit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) të LPK, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nga dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar nuk mund të kuptohet qartë dhe saktë se gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkespadiës së paditësit mbi çfarë baze juridike saktësisht ja ka njohur të drejtën e pronësisë në ngastrat kontestuese, mbi bazën e pohimit të kërkesës nga ana e të paditurve, mbi bazën e ndarjes fizike apo nga ndonjë bazë tjetër e paraparë me ligj.

Kur analizojmë dispozitivin dhe arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, por edhe konstatimin e bërë nga gjykata e shkallës së parë në faqen 7, pasusi i katërt, më të cilin ka konstatuar, citoj: se padia e paditësit është e bazuar në ligj, pasi që ai ju ka drejtuar gjykatës me qëllim që të ndajë bashkëpronësinë e tij si dhe të vertetojë se është pronar i vetëm në 1/1 e pasurisë si posedues kjo gjen mbështetje në nenin 56 të Ligjit nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore ku përcaktohet se shuarja e bashkëpronësisë bëhet përmes njërës nga këto mënyra: ndarjes, marrjes përsipër të sendit nga një bashkëpronar, braktisjes së sendit të luatshtëm, apo kur vendoset në anaknad publik të paluajtshmërive, për Gjykatën e Apelit është e paqartë se për cilën kërkesë të paditësit ka vendosur gjykata e shkallës së parë, pra a ka vendosur për kërkesën e tij për ndarje të bashkëpronësisë në mes tij dhe bashkëpronarëve tjerë lidhur me ngastrat kontestuese lëndore apo ka vendosur për vertetimin e pronësisë po për të njëjtat ngastra.

Nëse gjykata e shkallës së parë ka vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për vertetim pronësie, domosdoshmërisht ka pasur për detyrim që të tregojë se mbi cilën bazë juridike saktësisht ja ka njohur paditësit këtë të drejtë, kur dihet fakti se e drejta e pronësisë në paluajtshmeri fitohet sipas vetë ligjit (mënyrat e përcaktuara me ligj), në bazë të veprimit juridik, me trashëgimi dhe në bazë të vendimit të organit administrativ.

Mirëpo nëse gjykata e shkallës së parë ka vendosur për kërkesën e paditësit për ndarje fizike të paluajtshmërisë, paraprakisht është dashur që të vlerëson se një kërkesë e tillë e paditësi a mund të trajtohet sipas rregullave të procedurës kontestimore apo duhet zhvilluar në ndonjë procedurë tjetër, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit shuarja e bashkepronësisë në sende të paluajtshme përmes ndarjes fizike siç ju ka referuar gjykata e shkallës së parë në arsyetim por edhe dispozitiv në asnjë rrethanë nuk mund të bëhet në procedurë kontestimore, pasi që kjo çështje rregullohet decidivisht me dispozitat e Ligjit të Procedurës Jokontestimore dhe atë nenit (197-203), ku përcaktohet decidivisht procedura dhe çështjet tjera të ndarjes së pasurisë e cila është në bashkëpronësi. Pra në asnjë rrethanë ndarja fizike e sendeve të paluajtshme të cilat gjenden në bashkëpronësi në mes pronarëve nuk mund të bëhet në procedurën kontestimore.

Përveç tjerash kur shikojmë kërkesën e paditësit dhe provat shkresore, qartë mund të vijmë në përfundimin se paditësi lidhur me ngastrat lëndore veç është bashkëpronar në pjesën ideale prej 1/16, me çka kërkesa e paditësit që të vertetohet se është pronar i vetëm i këtyre ngastrave, duke përfshirë edhe pjesën ideale për të cilën veç figuron si bashkëpronar, nga gjykata e shkallës së parë do duhet të vlerësohet me rastin e ushtrimit të padisë por edhe me rastin e vendosjes meritore sepse ligjrisht pala që ushtron padinë çdoherë duhet të argumentoj se ka interes juridik për një gjë të tillë, pra për secilën kërkesë që parashtron para gjykatë.

Nën rrethanën e tillë gjykata e shkallës së parë paraprakisht gjatë shqyrtimit paraprak të padisë është dashur që të ftoj të autorizurin e paditësit që të bëjë sqarime të nevojshme në padi, duke u deklaruar qartë se a është duke kërkuar ndarjen fizike të paluajtshmërisë e cila gjendet në bashkëpronësi të tij dhe këtu të paditurve, respektivisht parardhësve të tyre apo është duke kërkuar vertetimin e pronësisë lidhur me pjesët ideale të ngastrave lëndore të cilat evidentohen në emër të të paditurve, respektivisht parardhësve të tyre, që pastaj duke pas para vetes një kërkesë të qartë të kishte mundësi që fillimisht të vlerësojë se sipas cilave rregulla procedurale do duhej të udhëhiqej çështja në fjalë (rregullave të procedurës kontestimore apo jokontestimore), dhe pastaj të administronte provat në drejtim të vertetimit të fakteve kontestuese m'varesisht prej kërkesës se saktë të cilën do ta parashtronte paditësi.

I bazuar qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese edhe për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e cila për rrjedhojë ka pas edhe aplikimin e gabuar të ligjit material, pasi që gjykata e shkallës së parë si shkak i paqartësisë së kërkesës së paditësit sipas padisë së ushtruar, me provat e nxjerrra nuk ka mundur të hetoj drejtë dhe në mënyrë të plotë se kur është shkëputur saktësisht bashkësia familjare në mes paditësit (babait të tij), dhe të paditurve, respektivisht parardhësve të tyre, me rastin e shkëputjes së bashkësisë së gjerë familjare kujt i kanë takuar në teren ngastrat lëndore dhe a ka pas marrëveshje për një gjë të tillë në mes të gjithë bashkepronarëve, kush i ka në posedim ngastrat lëndore dhe a është penguar ndonjëherë nga dikush prej bashkepronarëve, që pastaj duke vlerësuar edhe faktet tjera të çështjes lëndore gjykata e shkallës së parë të kishte një pasqyre të qartë, mbi bazën e se cilës pastaj do të kishte mundësi që duke aplikuar dispozitat e ligjit material në fuqi, m'varesisht prej periudhës kur paditësit ka mundur të lindë e drejta e kërkuar, të sillte një vendim të drejtë.

Pa marrë parasysh se në rastin konkret të paditurit gjatë shqyrtimit kryesor nuk e kanë kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, më përjashtim të këtu ankuesit H.M i cili e ka

kundershtuar gjatë gjithë shqyrtimit kryesor, gjykata e shkallës së parë mbi bazën e një deklarami të tillë të të paditurve nuk ka pasur mundësi që ta merr si të mirëqenë dhe të provuar kërkespadinë e paditësit duke vendosur sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, aq me tepër kur që nga fillimi kemi pasur të bëjmë më kërkesë të paqartë të paditësit për arsyet të cilat Gjykata e Apelit veç ju referua si më lartë dhe kërkespadia e paditësit është kundërshtuar nga i padituri H.M.

Kur analizojmë më detale arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë në faqen 7 pasusi i parafundit ka arsyetuar se, për gjykatën nuk ishte kontestues fakti se palët ndërgjyqëse për një kohë kishin jetuar në bashkësi familjare por më vonë atë e ndajnë se bashku me ndarjen e bashkësisë familjare, ata e ndajnë edhe pasurinë e tyre të përbashkët ashtu që në rastin konkret këtu paditësi hyn në posedim të pasurisë së tij alikuote të ndarë më vonë edhe në bazë të gjeodetit H.Th dhe të regjistruar në librat kadastral, me çka mbi bazën e një konstatimi të tillë mbetet e paqartë se cila ishte pjesa alikuote në të cilën paditësi kishte hyrë në posedim, a ishte ajo pjesë e ndarë në teren dhe a ishte në pëputhje me pjesën alikuote e cila i përgjigjet pjesën në të cilën paditësi është i regjistruar si bashkepronar me 1/16 pjesë ideale apo ajo përfshinte gjithë sipërfaqen e ngastrave lëndore kontestuese, dhe nëse po, kur saktësisht kishte hyrë paditësi në posedim të tyre, me rastin e futjes në posedim a ishte penguar nga dikush prej bashkepronarëve apo pasardhësve të tyre dhe kush saktësisht i ka tani në posedim ngastrat kontestuese lëndore.

Të gjeturat e konstatuara si më lartë nga kjo gjykatë, aktgjykimin e ankimuar si të tillë e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, për të cilat shkaqe i njëjti aktgjykim u dashtë që të priset dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë udhëzohet që fillimisht të ftoj paditësin që brenda afatit të përcaktuar me ligj të bëjë ndreqje të nevojshme të padisë, ashtu që të sqarohet se a është duke kërkuar ndarjen e bashkepronësisë lidhur me ngastrat kontestuese lëndore apo është duke kërkuar që të vertetohet se është pronar i ngastrave lëndore edhe në pjesët ideale në të cilat janë bashkepronar të paditurit tjerë.

Nëse paditësi vepron sipas urdhrit të gjykatës duke bërë ndreqje të nevojshme të padisë dhe gjykata vlerëson se kemi të bëjmë më kërkesë për ndarje fizike të bashkepronësisë, atëherë gjykata procedurën duhet ta vazhdojë sipas rregulave të procedurës jokontestimore, mirëpo nëse gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit ka të bëjë më vertetim pronësie lidhur me pjesët ideale në të cilat të paditurit, respektivisht parardhësit e tyre janë bashkepronar, atëherë gjykata ka për detyrim që të leshohet në shqyrtim të vlerësimit të fakteve të cilat janë kontestuese në mes ndërgjyqësve të cilat duhet të provojë përmes provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, që duke hetuar pastaj të gjitha faktet e çështjes të ketë mundësi që të bëjë një vendim të drejtë, i cili do ketë mbështetje në provat shkresore dhe në ligj.

Gjykata e shkallës së parë poashtu në rivendosje duhet të ketë në vëmendje se çfarë vendimi i nxjerrë më të cilin eventualisht kërkespadia e paditësit do të provohej si e themeltë sa i përket bazës së vertetimit të pronësisë lidhur me ngastrat lëndore, domosdoshmërisht duhet të përmbajë se mbi cilën bazë juridike paditësit i njihet një e drejtë e tillë, duke dhënë poashtu arsye të

mjaftueshme qoftë sa i përket të provuarit të fakteve vendimtare por edhe bazës së saktë ligjore të ligjit i cili ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi pretendon se i ka lindur, respektivisht ka fitur të drejtën e pretenduar.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitës ligjore të nenit 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3556/2022, me datë 11.10.2024

Kryetari i kolegjit
Qerim Ademaj, d.v